



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:119761
Datë: 07.08.2024
Numri i dokumentit: 06027927

K.DH.Shk II.nr.737/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit “ProCredit Bank Kosovë” ShA me seli në rrugën Xhorxh Bush nr.26 në Prishtinë, kundër debitorëve 1) “Cargomax Prishtina” ShPK me NUI 811168138 dhe seli në magjistralen Komoran-Carralevë në Drenas, 2) L.Sh. me vendbanim në rrugën ... nr.142 lagjja ... në Prishtinë, 3) L.Sh.1. me vendbanim në rrugën ... nr.142 lagjja ... në Prishtinë, 4) A.Sh. me vendbanim në rrugën ... nr.142 lagjja ... në Prishtinë dhe 5) “Allmakes Global Services Ash” ShPK me NUI 811168120 dhe seli në magjistralen Komoran-Caralevë në Drenas, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.141/23 të datës 31.01.2024, me datë **07.08.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorëve “Cargomax Prishtina” ShPK me seli në magjistralen Komoran-Carralevë në Drenas, L.Sh., L.Sh.1. dhe A.Sh. që të gjithë nga Prishtina, dhe 5) “Allmakes Global Services Ash” ShPK me seli në magjistralen Komoran-Caralevë në Drenas, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.141/23 të datës 31.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.141/23 të datës 31.01.2024, ne dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorëve “Cargomax Prishtina” ShPK me NUI

811168138 dhe seli në Drenas, L.Sh. me vendbanim në Prishtinë, L.Sh.1. me vendbanim në Prishtinë, A.Sh. me vendbanim në Prishtinë, “Allmakes Global Services Ash” ShPK me NUI 811168120 dhe seli në Drenas, i ushtruar kundër urdhrin përmbarrimor P.nr.05/2023 të datës 12.01.2023 të përmbarruesit privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitorët, (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anulohet vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.141/23 të datës 31.01.2024, dhe të bëhet vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet së cilës ka theksuar se aktvendimi i shkallës së parë është plotësisht i bazuar dhe i mbështetur në gjendjen faktike si dhe dispozitat ligjore. Andaj, gjykatës së shkallës së dytë i ka propozuar që ankesën e debitorëve ta refuzoj si të pabazuar dhe të vërtetojë vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.141/23 të datës 31.01.2024.

Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “ProCredit Bank Kosovë” ShA me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbarrim në zyrën e përmbarruesit privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë me të cilin ka kërkuar që nga debitorët “Cargomax Prishtina” ShPK me NUI 811168138, L.Sh., L.Sh.1., A.Sh. dhe “Allmakes Global Services Ash” ShPK me NUI 811168120, dhe me të dhëna tjera si në hyrje të këtij aktvendimi ta realizoj kërkesën në shumën prej 13,339.57€ si dhe shpenzimet e procedurë së përmbarrimit. Propozimit për përmbarrim ia kishte bashkëngjitur kopjen e kontratë kornizë FË89.2019; kopjen e kontratës dhe amendamentit nr.89077500, 89079045; kopjen e planit të pagesës; kopjen dokumentet e biznesit; kopje të dokumenteve të identifikimit; kopje të pasqyrës së borxhit; kopjen e noterizuar të kontratës së pengut nr.FË89.2019 dhe kopje e noterizuar të amendamentit të saj, dokumentin e titulluar “ lista e pengut” në emër të Debitorëve nr.kredisë FË89.2019; dokumente të titulluara “libreza të veturave” në emër të Debitorëve; konfirmimin e regjistrimit të pengut R-20190619-434 të lëshuar nga ARBK; si dhe dokumentet e identifikimit të palëve. Përmbarruesi më 12.01.2023 e ka nxjerrë urdhrin përmbarrimor P.nr.05/2023 me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbarrimin sipas Propozimit.

Debitorët më 20.01.2023 me një parashtrësë të përbashkët kanë paraqitur prapësim (duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarrimor dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj pa bazë ligjore atë. Ata kanë deklaruar se AGS në cilësi të Debitorit i është drejtuar me kërkesë Kreditorit, që të bëjë ri programimin e kredisë për shkak të pamundësisë së shlyerjes së borxhit e cila ka ardhur si pasojë e pandemisë, sidomos të vitit 2020 dhe 2021, thekson se me datë 12 dhjetor 2022 Kreditori ka refuzuar kërkesën e Debitorit që të riprogramoj kredinë. Sipas tij kjo çështje

përmbartimore duhet të trajtohet në procedurë kontestimore për arsye se: Dokumentet në bazë të cilave është marrë propozimi përmbartues nuk kanë titull ekzekutiv, përkatësisht nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë konform nenit 71, paragrafi 1.1 të LPP-së. Shton se propozimi për përmbartim është në kundërshtim me nenin 38 të LPP-së. Përveç kësaj ka deklaruar se nuk është caktuar radha e debitorëve solidar, duke theksuar se në propozim për përmbartim janë më shumë se dy Debitor solidar pra 4 Debitor të cilët janë përgjegjës solidar (bashkëkredimarrës) dhe se propozuesi nuk e ka caktuar radhën e Debitorëve si dhe përgjegjësisë solidare, sipas të cilave do të bëhej marrja e mjeteve, andaj sipas tij propozimi për përmbartim është në kundërshtim me nenin 39 të LPP-së. Prapësimi ia ka bashkëngjitur e-maillet me titull “Kërkesa për riprogramim të kredisë”, ndërsa nuk e kanë kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimi.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi atë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin. Ai ka deklaruar se prapësimi i Debitorit është tërësisht i pabazuar në ligj dhe se i njëjti është paraqitur vetëm sa për të penguar procedurën e ndërmarrjes së veprimeve përmbartimore. Ka shtuar se është i pabazuar dhe jo ligjor pretendimi që për shkak të pandemisë Covid-19 debitori të krijoj një lloj amnistie për mos pagimin e borxhit, për faktin që Kreditori përveç se ka financuar dhe përkrahur në vazhdimësi, të njëjtit dhe i është mundësuar paraprakisht ristrukturim i borxhit, ndërsa kërkesa e dytë është shqyrtuar nga Kreditori por e njëjta është refuzuar. Përveç kësaj ka deklaruar se është i pabazuar dhe jo ligjor pretendimi që Kreditori ka paraqitur dokumente të cilat kinse nuk i përmbushin kërkesa të parapara ligjore, pasi që ndërmjet palëve janë lidhur marrëveshje kontraktuale kreditore në të cilat janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet ligjore, e për sigurimin e obligimeve/borxheve që rrjedhin nga kjo marrëveshje janë lidhur kontrata mbi ekzekutimin e pengut FË89.2019 dhe amandamenti i saj, si dokument përmbartues me titull ekzekutiv, në kuptim të nenit 22 paragrafi 1.7 të LPP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 1.7 a. Për fund ka theksuar se Kreditori në propozim ka përcaktuar saktë të gjitha elementet dhe të dhënat përkatëse që rrjedhin nga marrëveshjet kreditore dhe marrëveshje e pengut, duke listuar sipas radhës debitorit solidar (bashkëkredimarrës) dhe marrja e mjeteve do të bëhet sipas asaj radhe që janë përmendur në propozim për përmbartim konform nenit 39.2 të LPP-së. Përgjigjes në prapësim nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e përgjigjes në prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimi, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.141/2023 të datës 31.01.2024, duke vendosur si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar të gjitha këto kushtet të kërkuara me LPP për caktimin e përmbartimit në bazë të kontratës për pengun, pasi pengu është i regjistruar në Regjistrin e Pengut në ARBK me vlefshmëri nga data 19.06.2019 deri 19.07.2024.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarimin sipas dokumentit të përmbarimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 dhe me nenin 5 par.2 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, Ligjit për Procedurën Përmbarimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore ku në mesin e dokumenteve përmbarimore në bazë të cilave organi përmbarues mund të caktoj përmbarimin është kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit si dhe edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Dhoma e Shkalles se Dytë, vlerëson se dokumenti në bazë të cilit është lejuar urdhri përmbarimor paraqet dokument përmbarimor, për faktin se në rastin konkret përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin duke u bazuar në kopjen e noterizuar të kontratës së pengut nr.FË89.2019 dhe kopje e noterizuar të amendamentit të saj, dokumentin e titulluar “ lista e pengut” në emër të Debitorëve nr.kredisë FË89.2019; dokumente të titulluara “libreza të veturave” në emër të Debitorëve; konfirmimin e regjistrimit të pengut R-20190619-434 të lëshuar nga ARBK; dhe te njëjtat paraqesin dokumente përmbaruese në kuptim të dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, me të cilën parashihet se “1. *Dokumente përmbaruese janë 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*” ndërsa me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore me nenin 5 përcaktohet si në vijim” 2. *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7.,shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.*

Gjykata e shkalles se dytë ka analizuar edhe pretendimet debitorëve se nuk kanë pasur mundësi të shlyerjes së borxhit e cila pamundësi ka ardhur si pasoj e pandemisë, pasi ky fakt nuk paraqet shkak nga neni 71 i LPP, në bazë të cilit mund të anulohet urdhri përmbarimor dhe si te tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi ti refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet

ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II nr.737/24. me datë 07.08.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajram**